

## SYLLABUS

Lënda: Perspektiva e re në pikturë II (*Hulumtim, eksplorim stilistik, reflektim teorik & praktikë*)

Viti -II- (Semestri: III - IV)

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Arteve Programi i studimit - Artet Vizuale (BA) – Art Konceptual dhe Mediat e reja, Ilustrim dhe Vizatim
<b>Titulli i lëndës:</b>	Perspektiva e re në pikturë II
<b>Niveli:</b>	Bachelor (BA)
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti -II- (Semestri: III - IV)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	4+4 (dy simestra 8 ECTS)
<b>Koha / lokacioni:</b>	E hënë, 14:00-15:30 E enjte: 9:00-10:30 A1/14 UP/FA/DAB (Ligjerata) A1/07 UP/FA/DAB (Ushtrime laboratorike)
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Majlinda Kelmendi
<b>Detajat kontaktuese:</b>	Email: majlinda.kelmendi@uni-pr.edu Tel.: +383 44 146 036
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	
	<i>Perspektiva e Re në Pikturë II</i> ofron një eksplorim të avancuar të koncepteve dhe praktikave bashkëkohore në pikturë, duke i ndihmuar studentët të zhvillojnë më tej njohuritë, aftësitë teknike dhe qasjen konceptuale. Përmes analizës së veprave artistike, diskutimeve teorike dhe zhvillimit të projekteve individuale. Lënda inkurajon një qasje kritike, eksperimentale dhe reflektuese ndaj procesit krijues. Studentët do të hulumtojnë ndikimin e konteksteve kulturore dhe sociale në artin bashkëkohor dhe do të aplikojnë praktika inovative që sfidojnë kufijtë tradicionalë të pikturës. Përmes ushtrimeve të avancuara, analizave dhe reflektimeve, do të zhvillojnë një stil personal që ndërthur teorinë dhe praktikën në mënyrë të vetëdijshme dhe bashkëkohore.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Lënda synon të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thellojë kuptimin e studentëve mbi konceptet bashkëkohore dhe filozofike të pikturës.</li> <li>• Nxisë reflektimin kritik mbi rolin e artistit dhe procesin krijues.</li> <li>• Inkurajojë zhvillimin e një stili personal dhe të pavarur përmes eksperimentimit me teknika dhe media të ndryshme.</li> <li>• Ndihmojë studentin të integrojë njohuritë teorike dhe praktike në mënyrë të balancuar.</li> <li>• Përgatisë studentët për të qenë aktivë në kontekste bashkëkohore të artit (ekspozita, projekte, konkurse).</li> <li>• Të zhvillojë aftësi për të reflektuar dhe dokumentuar procesin e punës në mënyrë kritike.</li> </ul>

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti pritet të jetë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijojë vepra që zbatojnë koncepte dhe teknika të avancuara në pikturë.</li> <li>2. Analizojë dhe interpretojë në mënyrë kritike veprat e artistëve bashkëkohorë.</li> <li>3. Reflektojë mbi procesin krijues përmes eseve dhe deklaratave artistike.</li> <li>4. Demonstrojë aftësi për prezantim profesional të punës së tij përmes portofolit.</li> <li>5. Zhvillojë një qëndrim të pavarur artistik, duke ndërthurur teorinë me praktikën.</li> </ol>
----------------------------------	---

Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata.	4	30/30	120
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2/1	2
Punë praktike	1	1/10	10
Kontaktet me mësimmshënës/konsultimet.	1	1/8	8
Ushtrime në terren	2	2/2	4
Kollokfiime,Seminare	2	2/1	2
Detyra të shtëpisë	1	1/10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	2/10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	4	4/3	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1/6	6
Projektet, prezentimet etj.	2	2/3	6
<b>Totali</b>			<b>200</b>

Lënda **Perspektiva e Re në Pikturë II** zhvillohet gjatë dy semestrave (Semestri III dhe IV), me gjithsej **8 ECTS**, të ndara si vijon:

4 ECTS në Semestrin III (100 orë pune)

4 ECTS në Semestrin IV (100 orë pune)

Shënim: “Kollokfiime, seminare (reflektime, prezantime)

<b>Metodologjia e mësimmshënies:</b>	Metodologjia e mësimmshënies në <i>Perspektiva e Re në Pikturë II</i> bazohet në ndërthurjen e <b>mësimit teorik dhe praktik</b> përmes metodave bashkëkohore dhe reflektuese. Ajo synon të nxisë krijimtarinë, mendimin kritik dhe pavarësinë artistike të studentëve përmes kombinimit të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjërata dhe diskutime tematike</li> <li>• Punë praktike në studio</li> <li>• Analizë vizuale dhe kritikë kolektive</li> <li>• Ese dhe shkrim reflektiv</li> </ul>
--------------------------------------	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantime individuale dhe grupore</li> <li>• Vizita në institucione artistike dhe ekspozita</li> </ul>
Metodat e vlerësimit: Sistemi i vlerësimit me pikë.	<p>Vlerësimi në përputhje me <b>rregulloren e Përgjithshme për Vlerësimin e Performancës së Studentëve</b>, të miratuar nga Senati i UP-së, për këtë kurs bazohet në një sistem pikësh që mat angazhimin, performancën dhe rezultatet e studentëve gjatë semestrit. Totali maksimal i pikëve është 100, të ndara si më poshtë:</p> <p>Komponentët e Vlerësimit:</p> <p><b>1. Provimi i semestrit III – 25 pikë</b> Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të parë dhe projektet praktike dhe me shkrim të zhvilluara.</p> <p><b>2. Provimi i semestrit IV – 25 pikë</b> Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të dytë dhe projektet praktike të zhvilluara.</p> <p><b>3. Pjesëmarrja aktive dhe vijimi i rregullt – 10 pikë</b> Vlerësohet përmes pranishmërisë së rregullt në orë dhe angazhimit aktiv në diskutime.</p> <p><b>4. Provimi përfundimtar – 40 pikë</b> Prezantimi i një projekti përmbledhës. Ky projekt vlerëson njohuritë dhe kreativitetin e studentit dhe projektet praktike të zhvilluara.</p> <p><b>Sistemi i Notimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 91% – 100% e pikëve totale: Nota 10 (shkëlqyeshëm)</li> <li>• 81% – 90% e pikëve totale: Nota 9 (shumë mirë)</li> <li>• 71% – 80% e pikëve totale: Nota 8 (mirë)</li> <li>• 61% – 70% e pikëve totale: Nota 7 (mjaftueshëm)</li> <li>• 51% – 60% e pikëve totale: Nota 6 (kalues)</li> <li>• &lt; 51% e pikëve totale: Nota 5 (nuk kalon)</li> </ul>
<b>Literatura</b>	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bourriaud, N. (2002). <i>Postproduction: Culture as Screenplay</i>. New York, Lukas &amp; Sternberg.</li> <li>• Buskirk, M. (Ed.). (1996). <i>The Duchamp Effect: Essays, Interviews, Round Table</i>. Cambridge, MA, MIT Press.</li> <li>• Denegri, J. (1995). <i>Dossier Beuys</i>. Belgrade, SKC.</li> <li>• Dexter, E. (Ed.). (2005). <i>Vitamin D: New Perspectives in Drawing</i>. London, Phaidon Press.</li> <li>• Elger, D. (2004). <i>Dadaism</i>. Cologne, Taschen.</li> <li>• Oliva, A. B. (2000). <i>L'Arte fino al 2000</i>. Milan, Electa.</li> <li>• Schwabsky, B. (Ed.). (2002). <i>Vitamin P: New Perspectives in Painting</i>. London, Phaidon Press.</li> </ul> <p><b>Burime të rekomanduara digjitale</b> Studentët obligohen të përdorin materialet e ofruara nga <b>Biblioteka Universitare e Universitetit të Prishtinës</b>, përfshirë <b>librat digjitalë, databazat akademike dhe</b></p>

	<p><b>platformat me qasje të hapur</b>, të cilat përmbajnë literaturë teorike dhe vizuale relevante për lëndën.</p> <p>Burimet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Biblioteka Universitare e Kosovës</a></li> <li>• <a href="#">Biblioteka Digjitale e Kosovës</a></li> <li>• <a href="#">Universiteti i Prishtinës – Biblioteka</a></li> <li>• <a href="#">Project Gutenberg – Open Access Library</a></li> <li>• <a href="#">Springer Open Access Books</a></li> <li>• <a href="#">DOAB – Directory of Open Access Books</a></li> <li>• <a href="#">Rudolph Muteswa – Artist Resources</a></li> </ul> <p>Linqet:</p> <p><a href="https://www.biblioteka-ks.org/#">https://www.biblioteka-ks.org/#</a>  <a href="https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents">https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents</a>  <a href="https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137">https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137</a>  <a href="https://www.gutenberg.org">https://www.gutenberg.org</a>  <a href="https://www.springer.com/gp/open-access/books">https://www.springer.com/gp/open-access/books</a>  <a href="https://doabooks.org">https://doabooks.org</a>  <a href="https://rudolphmuteswa.com">https://rudolphmuteswa.com</a></p>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Adorno, T. W. (1997). <i>Aesthetic Theory</i>. London, Continuum.</li> <li>• Arnheim, R. (1969). <i>Visual Thinking</i>. Berkeley, University of California Press.</li> <li>• Godfrey, T. (1998). <i>Conceptual Art</i>. London, Phaidon Press.</li> <li>• Osborne, P. (2002). <i>Conceptual Art</i>. London, Routledge.</li> </ul>

<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet në Semestrin III</b>
<i>Java e parë</i>	Prezantimi i lëndës, objektivave dhe metodologjisë. Diskutim mbi zhvillimet bashkëkohore në pikturë dhe konceptin e lëndës
<i>Java e dytë</i>	Analizë e formës dhe hapësirës në kontekstin bashkëkohor. Ushtrime mbi perceptimin vizual dhe marrëdhënien midis shikuesit dhe veprës.
<i>Java e tretë</i>	Ngjyra si koncept dhe përjetim. Ushtrime për ndërveprimin e ngjyrave dhe për dimensionin emocional të tyre.
<i>Java e katërt</i>	Materialiteti në pikturë: trajtim i materialeve jo-tradicionale. Eksperimentim me tekstura dhe media të përziera.
<i>Java e pestë</i>	Integrimi i elementeve të rastësisë si pjesë e procesit krijues. Diskutim mbi spontanitetin dhe kontrollin në art.
<i>Java e gjashtë</i>	Përdorimi i simbolit dhe metaforës vizuale. Analizë e veprave që ndërthurin narrativën me abstraksionin.
<i>Java e shtatë</i>	Konteksti social në pikturë: ndikimi i realitetit urban dhe mediave vizuale. Ushtrime reflektuese mbi përvojën personale.
<i>Java e tetë</i>	Vizitë në galeri ose ekspozitë. Diskutim kritik dhe reflektim mbi veprat e ekspozuara.
<i>Java e nëntë</i>	Kombinimi i pikturës me elemente të fotografisë ose kolazhit. Ushtrime për eksperimentim vizual.

<i>Java e dhjetë</i>	Hulumtim konceptual dhe zhvillim i një ideje personale për projekt semestral.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Konsultime individuale mbi procesin e punës dhe formulimin e konceptit.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Prezantim i përkohshëm (work-in-progress). Diskutim dhe reflektim grupor mbi fazat e krijimit.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Përmirësim i projektit fokus në qartësimin e idesë dhe zbatimin teknik.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Përgatitje për prezantim përfundimtar. Organizim dhe dokumentim i procesit.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Prezantim i projekteve semestrale dhe reflektim mbi përvojën krijuese. <i>Vlerësimi i semestrit III</i>

<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet në Semestrin IV</b>
<i>Java e parë</i>	Diskutim mbi procesin si formë arti. Prezantim i artistëve që fokusohen në artin procesual dhe ndërveprues.
<i>Java e dytë</i>	Piktura si hapësirë instalative. Eksperimentim me formate të mëdha dhe përfshirje të elementeve tredimensionale.
<i>Java e tretë</i>	Piktura dhe teknologjia: analiza e ndërthurjes midis mediave tradicionale dhe digjitale.
<i>Java e katërt</i>	Përjetimi vizual. Ushtrime mbi interpretimin e perceptimit.
<i>Java e pestë</i>	Krijimi i serive pikurale me koncept të përbashkët. Planifikimi i strukturës vizuale dhe narrative.
<i>Java e gjashtë</i>	Analizë. Vizitë në galeri ose ekspozitë. Diskutim mbi zhvillimin e veprës.
<i>Java e shtatë</i>	Eksperimentim me koncepte të hapësirës, dritës dhe kohës në pikturë.
<i>Java e tetë</i>	Prezantim i hulumtimeve dhe ideve të studentëve për projektin përfundimtar.
<i>Java e nëntë</i>	Zhvillimi praktik i projektit përfundimtar me mbështetje nga profesori.
<i>Java e dhjetë</i>	Konsultime individuale për procesin dhe dokumentimin vizual.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Analizë kritike e punës personale dhe përgatitje për prezantim.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Prezantim i projekteve në fazë përfundimtare. Diskutim kritik në grup.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Dorëzimi i projektit final dhe i dokumentacionit vizual. Reflektim mbi procesin.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Diskutime për konceptet e mësuara dhe lidhja e tyre me artin bashkëkohor.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Prezantim i projekteve përfundimtare. <i>Vlerësim përfundimtar i semestrit IV.</i>

#### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet të jenë të pranishëm në klasë të paktën 15 minuta përpara fillimit të orës, për t'u përgatitur për mësim. Përdorimi i telefonave celularë gjatë orës nuk lejohet; ata duhet të jenë të fikur ose në modalitet të heshtur. Kërkohet respektimi i qetësisë dhe i një ambienti akademik të përshtatshëm gjatë procesit mësimor. Orari i përcaktuar i përfundimit të mësimit duhet të respektohet me korrektësi. Mosrespektimi i orarit apo sjellja joetike gjatë procesit mësimor ndikon në notën përfundimtare dhe në vlerësimin e pjesëmarrjes aktive.

Përgatitur: Prof. Majlinda Kelmendi

*Prishtinë, 2025*